



REPUBLIKA KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:224361

Datë: 18.11.2024

Numri i dokumentit: 06466600

C-IV.-14-3623

Ankuesi

M D, Beograd, Serbi.

Përfaqësuar nga “Projekti për Ndihmë Juridike Falas Graçanicë.

Kundër

E paditura

N.SH “Zastava – Ramiz Sadiku”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Dr.sc. Murat Hulaj, me dt.18 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e ankuesit, dhe **VËRTETOHET** vendimi Autoritetit të Likuidimit nr.PEJ089-0709 i dt.07 prill 2014.
- 2. Secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.13 maj 2014, ankuesi parashtror ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PEJ089-0709 i dt.07 prill 2014, me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për paga të pa paguara në shumë prej 88,800.00€, nga N.SH “Zastava – Ramiz Sadiku” (në likuidim). Ankuesi në ankesë ka pohuar se është larguar nga Kosova në vitin 1999 për shkak të rrethanave të krijuara por se i takon kompensimi në bazë të dispozitave ligjore për periudhën kohore 1999-2013. Të njëjtës i ka bashkangjitur Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Kopjen e librezës së punës.

Me dt.19 korrik 2021, e paditura AKP ka parashtruar mbrojtje ku ka pohuar se vendimi i AL nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore në fuqi janë zbatuar drejtë. Konsideron se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të kundërshtuar. Parashtruesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur AL me vendimin e saj dhe nuk ka ofruar asnjë argument ligjor. Ka kërkuar që në bazë të dispozitave ligjore, gjykata ta refuzoj ankesën e ankuesit.

Me dt.24 korrik 2024, gjykata ka kërkuar nga ankuesi që të bëjë dorëzimin e provave shtesë, ndër to librezën e punës, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, listën e pagave si dhe prova tjera shtesë me të cilat i mbështet pretendimet ankimore. Projekti për Ndihmë Juridike Falas e ka pranuar urdhrin dhe me dt. 08 gusht 2024 i është përgjigjur gjykatës përmes parashtrësës duke bërë dorëzimin e këtyre provave: kopjen e librezës së punës, kopjen e aktvendimit nr.2590 dt.26.04.1978, kopjen e vendimit për vendosje të punëtorëve nr.2590 dt.25.09.1981, Kopjen e vendimit nr.2593 dt.30.04.1983, Kopjen e vendimit nr.2593 dt.12.06.1986, Kopjen e vendimit nr.2593 dt.11.04.1989.

Arsyvetimi ligjor

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensim për paga të pa paguara për periudhën kohore 1999-2013.

Ankuesi ka dorëzuar Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Kopjen e librezës së punës, “Uverenje”, kopjen e aktvendimit nr.2590 dt.26.04.1978, kopjen e vendimit për vendosje të punëtorëve nr.2590 dt.25.09.1981, Kopjen e vendimit nr.2593 dt.30.04.1983, Kopjen e vendimit nr.2593 dt.12.06.1986, Kopjen e vendimit nr.2593 dt.11.04.1989. Ankuesi ka dështuar që të dorëzoj prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas parashtrimit të urdhrimit të dt.24 korrik 2024.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi e ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se sa ka qenë shuma që NSH i ka mbetur borxh, duke e dëshmuar me listë të pagave, po ashtu përmes njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, do të dëshmonte se kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Ankuesi në ankesë ka pohuar se i kërkon pagat për periudhën kohore 1999-2013, por i njëjti po ashtu ka pohuar se është larguar nga Kosova në vitin 1999, ashtu që nuk ka ofruar shërbime për ndërmarrjen gjatë periudhës kohore për të cilën i ka kërkuar pagat. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Provat të cilat i ka dorëzuar ankuesi nuk dëshmojnë të drejtën e pretenduar, andaj dhe pretendimet e tij nuk janë të bazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Në pajtim me nenin 13 par.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr.01/2017, ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, pasi që është përfitues i Ndhmës Juridike Falas.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r i,
Dr.sc.Murat Hulaj